



**Për: Mediat e shkruara dhe elektronike**  
**Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim**  
**Subjekti: Deklaratë**

---

*Prishtinë, 14 shkurt 2008*

## DEKLARATË

Të nderuar qytetarë, anëtarë dhe simpatizantë të Aleancës Kosova e Re,

Tani është afruar momenti historik për Kosovën, Popullin e saj dhe po vihen themelet e shtetndërtimit të vendit tonë.

Këto ditë pritet shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

Është shumë me rëndësi që këtë akt, gjegjësisht momentin e deklarimit të saj, ta përjetojmë me pjekuri, dinjitet dhe pa eufori.

Për Kosovën është me rëndësi Pavarësia dhe fillimi i ndërtimit të shtetit të së drejtës, shtetit demokratik, multietnik, multifetar dhe inkuadrimi i Kosovës në proceset integruuese drejt shoqërive demokratike dhe të përparuara.

Pavarësia e Kosovës nuk është befasi e rastit, por meritë që del nga një proces i gjatë, me shumë sakrificë dhe flijime.

Përpjekjet shekullore të Popullit të Kosovës për Liri dhe e drejta për të jetuar i barabartë me të tjerët, tani po kurorëzohen me Pavarësinë e shumëpritur. Për këtë ne, Aleanca Kosova e Re, u jemi mirënjohës të gjithë brezave që vepruan, e sidomos atyre që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre.

Ne u jemi mirënjohës të gjithë botës demokratike, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Europës, dhe miqve tanë kudo në botë, që të drejtën tonë legjitime për Pavarësi e mundësuan të bëhet realitet. Miqtë e Kosovës, Organizata e Kombeve të Bashkuara me praninë e tyre në Kosovë, bashkë me organizatat tjera qeveritare dhe joqeveritare, si dhe KFOR-in, mundësuan që Kosova të përgatitet në mënyrë të denjë për aktin e Pavarësisë, për çka Populli i Kosovës do t'u jetë mirënjohës gjithmonë. Aleanca Kosova e Re, duke falënderuar, dëshmon fuqishëm se të gjithë këta që përmendëm, mbeten pjesë e historisë së lavdishme të Kosovës.

Qytetarë të nderuar,

të tregojmë me maturi se Pavarësia është dëshmia e pjekurisë sonë për shtetndërtim.

T'i ikim provokimeve të mundshme dhe t'i gëzohemi Pavarësisë në mënyrë të natyrshme, të festojmë në familje me miq, ta përjetojmë shpirtërisht, që kjo ditë të jetë një festë e shenjtë.

Ne, Aleanca Kosova e Re, përgëzojmë gjithë Popullin e Kosovës pa dallim etnie, feje, race, për Pavarësinë dhe fillimin e ndërtimit të shtetit më të ri në botë.

Pavarësia është e gjithë Popullit të Kosovës.

Kosova e pavarur tani është shumë më afër fqinjëve të saj, do të jetë një shtet i civilizuar, pa kufij klasikë, do të garantojë barazinë e të gjithëve që jetojnë e donë të jetojnë në Kosovë, atyre që e donë Kosovën, do të garantojë Lirinë e plotë të lëvizjes së njerëzve, ideve, mallrave dhe kapitalit.

Kosova do të jetë e integruar në rajon dhe shpejt do të jetë pjesë e Evropës Demokratike.

Pavarësia i hap horizontin Kosovës për punë, zhvillim ekonomik dhe prosperim të gjithëmbarshtëm, për çka unë, qytetarë të nderuar, apeloj te Ju, që të mobilizohemi për këto sfida.

Me fat të gjithëve!

Behgjet Pacolli,  
Kryetar i Aleancës Kosova e Re